



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja Nr. 45
Prishtinë, më 7.10.2010, ora 9:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

e mbledhjes së jashtëzakonshme të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Sanije Aliaj, Enis Kervan, Rexhep Hoti, Sadik Idriz, Xhevdet Neziraj, Numan Balić, Zylfi Merxha, Hafize Hajdini, Mursel Haljilji dhe Hetem Arifi.

Munguan: Petar Miletić, Müfera Şinik dhe Dragiša Mirić .

Nga Stafi Mbështetës: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Sanije Aliaj, zëvendëskryetare e Komisionit

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

Kryesuesja- konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen vetëm me një pikë të rendit të ditës.

- 1. Shqyrtimi i Projektligjit për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe të Banesave me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Administrate Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente;**

Kryesuesja- i njoftoi Komisionin se mbledhja e sotme është thirrur me kërkesë të ministres Edita Tahiri dhe të përfaqësuesve të ICO-së që Komisioni urgjentisht të procedojë Projektligjin për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe të Banesave. Gjithashtu theksoi se nuk është votuar amendamenti i grupit KDTP.

Kryesuesja, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës fjalën ia dha Enis Kervan.

Enis Kervan- Në fjalën e tij diskutoi lidhur me amendamentin e Raportit me rekomandime të Projektligjit për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe të Banesave nr. 03/L-237 të datës 6. tetor 2010, dhe para komisionit paraqiti ndryshimin e nenit 14.1.5, me tekstin si vijon:

‘dhe sipas gjuhëve që kanë statusin e gjuhëve në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në përdorim gjuhët zyrtare në komuna’.

Pasi që nuk është arrit asnjë marrëveshje, komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

- I. Lidhur me propozimin e deputetit Enis Kervan (propozim amendamenti i grupit KDTP) Komisioni nuk u deklarua.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim në mbledhjen e mbajtur me 7.10.2010 në Seancë Plenare nuk do të ketë Raport me rekomandime lidhur me Projektligjin për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe të Banesave.

Mbledhja përfundoi në orën 9:45

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit

Sanije Aliaj